



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/01/25

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. E.K ndaj gjyqtarit E.M, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 12.02.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. E.K ndaj gjyqtarit E.M për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Av. E.K me datë 22.01.2025 ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit E.M, me pretendimet për shkelje disiplinore gjatë trajtimit të lëndës C.nr.15947/24.

Parashtruesi i ankesës në ankesën e tij ka deklaruar se gjyqtari Propozimi për caktimin e masës së sigurisë në lëndën C.nr.15947/24 është paraqitur me datë 23.01.2024, para një viti, ndërsa deri më tani gjyqtari ka shkelur detyrat e tij zyrtare si gjyqtar duke mos respektuar parimin e paanshmërisë gjyqësore me veprimet procedurale të cilat i ndërmerr.

Sipas saj, se gjyqtari i çështjes nuk respekton parimin e paanshmërisë gjyqësore janë disa veprime të ndërmarra nga gjyqtari gjatë procedurës përgatitore për seancën dëgjimore dhe veprimet e tij gjatë seancës në raport me palën. Tutje ka deklaruar se gjyqtari nuk ka përfillur argumentet e cekura nga e autorizuar e propozuesit e cila në seancë ka deklaruar se adresat e kërkuara për palët e kundërshtarëve të propozimit janë të sakta dhe nuk ka adresa të tjera, mirëpo sipas saj përkundër faktit se gjykatës ja kemi dorëzuar dy herë adresat për kundërshtarët e masës së sigurisë, gjykata pa asnjë argument ka marrë aktvendim për tërheqjen e propozimit për caktimin e masës, i cili aktvendim është prishur nga Gjykata e Apelit dhe është kthyer në rivendosje.

Parashtruesja e ankesës tutje ka deklaruar se në seancën e datës 15.01.2025 ka deklaruar bindshëm se adresat e cekura për B.M janë të sakta, por gjyqtar nuk i ka dhënë mundësinë për tu deklaruar se cilat janë argumentet e tyre në këtë drejtim, por ka qenë i prerë duke deklaruar se “ në shkresat e lëndës i kemi provat se B.M i kemi dërguar tri ftesa të cilat janë kthyer me konstatim se adresat nuk janë të sakta”, por nuk ka dhënë njoftim se në cilat data i janë dërguar

ftesat, cili është konstatimi në fletë dorëzim dhe nga kush është tentuar dorëzimi, nga dorëzuesi i gjykatës a po nga dorëzuesi i Postës së Kosovës, për të cilët sipas tyre kanë dyshime se dorëzuesit me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe për të cilët do të paraqesin kallëzim penal, sepse sipas parashtruesit të ankesës adresa është e njohur për dorëzuesit të cilët në këtë adresë disa herë B.M i kanë dorëzuar ftesa të gjykatës në procedurë penale.

Tutje ka deklaruar se gjyqtari E.M me veprimet e tij ka imponuar vullnetin e tij që përkundër se nuk ekzistojnë kushtet ligjore, lëndën ta orientojë në drejtimin e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm për kundërshtarin e parë të sigurisë, edhe pse kjo gjë nuk mund të bëhet pasi që të njëjtit i dihet botërisht adresa dhe punon jo larg Pallatit të Drejtësisë.

Ndër të tjera, parashtruesja e kërkesës ka deklaruar se në seancën e datës 15.01.2025 e autorizuar e propozuesit ka deklaruar se në këtë adresë B.M i pranon të gjitha shkresat në procedurën penale, me ç rast gjyqtar ka deklaruar “dërgo masën atje”. Mënyra e komunikimi nuk është profesionale dhe tek pala ka shprehur mos siguri për paraqitjen e argumenteve nëse seancë.

Tutje parashtruesja e kërkesës ka deklaruar se propozimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm nuk e kanë propozuar ata si palë, por përkundër insistimit tonë se adresa është e saktë dhe nuk kemi tjetër adresë për kundërshtarin e parë të sigurimit, gjyqtari në procesverbalin e seancën e ka shënuar në mënyrë të pavërtetë si propozim të përfaqësueses, duke tërhequr vërejtjen se “ procedura me përfaqësues të përkohshëm merre kohë – e din këtë avokatja”, me çka sipas saj është vërtetuar dyshimi se gjyqtari me qëllim vepron në anën e palës kundërshtare dhe gjenë mënyra procedurale për zhagjitjen e procedurës, në mënyrë që pala sa më gjatë të shfrytëzojë pasurinë objekt i çështjes.

Tutje parashtruesja e kërkesës ka deklaruar se gjyqtari nuk e ka arsyetuar nëse është bërë përpjekje për dërgim të ftesës në vendin e punës ashtu sikurse është paraparë në nenin 109, 110, 111,112 dhe 113 të LPK-së dhe në kundërshtim me të gjitha provat dhe në kundërshtim me nenin 79 par. 3 pika(a) të LPK-së pa u plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, në procesverbal të seancës dëgjimore në mënyrë të pavërtetë shënon propozimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm.

Sipas saj, nga sjelljet jo profesionale të gjyqtarit, komentet jashtë procesverbalit dhe situata e krijuar në seancën nuk e kemi lexuar procesverbalin por vetëm e kemi nënshkruar dhe menjëherë jemi larguar nga zyra e gjyqtarit me bindjen në paanësinë e gjyqtarit për të cilin është kërkuar edhe përjashtimi.

Në fund ka deklaruar se gjyqtari në seancën dëgjimore palën propozuese dhe përfaqësuesit nuk e ka trajtuar siç kërkohet me ligj(neni 5 par. 2 pika 2.2 i Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke komentuar jashtë rregullave të mbajtjes së seancës dëgjimore dhe procesverbalit në të cilin janë shënuar të pavërteta, duke propozuar që të veprohet në kuadër të kompetencave ligjore për ankesën e paraqitur.

Në referim të pretendimeve të paraqitura, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se këto pretendime nuk qëndrojnë dhe nuk është fakt notor se cila është adresa e kundërshtarit të sigurimit B.M, përderisa gjyqtar asnjëherë nuk ka mundur të komunikoj me të, fakt ky i cili provohet nga fletë kthesat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas gjyqtarit, pretendimet e ngritura nga përfaqësuesja e autorizuar e propozuesit, lidhur me anshmërinë e gjyqtari të çështjes nuk kanë bazë dhe se në drejtim të procedimit sa më efikas dhe të drejtë të çështjes gjykata ka tentuar disa herë të komunikoj me kundërshtarin e sigurimit B.M, në adresat e tij, ashtu që fillimisht ka provuar t ia dërgojë me postë njoftimin për masë të sigurimit në adresën e dhënë me propozim nga propozuesit i sigurimit, mirëpo fletë dërgesa e datës 11.03.2024 është kthyer me konstatimin se pala është e panjohur, ndërkaq gjykata ka tentuar sërish që përmes fletë dorëzuesve të gjykatës ta ftojë kundërshtarin e sigurimit B.M për seancën e datës 15.01.2025, duke ia bashkangjitur njoftimin për masë të sigurimit, si dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit me shenjën CA.nr.10508/254 të datës 21.10.2024, mirëpo fletë dërgesat për dorëzim personal të datës 26.11.2024, 09.12.2024 dhe 20.12.2024 që gjenden në shkresat e lëndës, janë kthyer me konstatimin se në adresën e cekur banon një familje tjetër, ndërkaq në fletë kthesën tjetër të datës 11.12.2024 është kthyer konstatimi i fletë dorëzuesve se kjo adresë është jo e plotë si dhe banorët kanë deklaruar se nuk e njohin palët.

Tutje gjyqtari ka deklaruar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet që kundërshtarit të sigurimit B.M ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, bazuar në dispozitën e nenit 79 par. 3 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku shprehimisht thuhet se “gjykata do ti caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm, në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë”, me dispozitën e nenit 81 par. 1 po të njëjtit ligj shprehimisht thuhet se “gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve, ndërsa me par. 2 të nenit 81 po të njëjtit ligj shprehimisht thuhet se në rastet nga par. 2 i nenit 79 të këtij ligji i padituri ka për detyrë të deponoj shumën e të hollave për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurs enë rastet nga par. 3 i njëjti en shpenzimet i deponon paditësi.

Në fund ka deklaruar se nuk qëndrojnë asnjëra nga pretendimet e tjera të theksuara në ankesë ngase gjyqtari i çështjes ka bërë përpjekje që të krijohen prezumimet procedurale për vendosje lidhur me propozimin për masë të sigurimit dhe në rastin konkret për gjykatën adresa e kundërshtarit të sigurimi është e panjohur dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoriteti Kompetent gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Nuk është kontestuese se me datë 15.01.2025 është mbajtur seanca gjyqësore në Divizionin Civil me gjyqtar E.M, në lëndën C.nr.15947/24 për shqyrtim të propozimit për masë të sigurisë.

Në bazë të shkresave të lëndës, shihet se gjykata ka tentuar disa herë që të komunikojë me kundërshtarin e sigurimit në adresat e dhëna nga propozuesi i sigurimit, por që të gjitha fletë dërgesat janë me konstatime të tilla si “*pala e panjohur*” a po konstatimet “*në këtë adresë banon një familje tjetër*”.

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se kundërshtari i sigurimit i pranon të gjitha shkresat në procedurë penale në këtë adresë, nuk është relevante të shqyrtohet në procedurë civile, pasi që

për gjyqtarin e çështjes është e nevojshme komunikimi me palën në procedurë civile, pavarësisht faktit se me të njëjtin është krijuar komunikim në të njëjtën adresë në ndonjë procedurë tjetër.

Në lidhje me pretendimin për shkelje disiplinore të parapara me nenin 5 par. 2 pika 2.2 të Ligjit nr. 06/L-057, Kryetarja e Gjykatës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese se gjyqtari nuk i ka trajtuar të gjitha palët siç kërkohet me ligj, pasi që në këtë drejtim parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për të argumentuar se si rezultat i cilave fakte ka arritur të konstatoj një rrethanë të tillë. Pretendimi i parashtrueses së kërkesës se gjyqtari ka konstatuar në procesverbal në mënyrë të pavërtetë se kinse e njëjta ka paraqitur propozim për përfaqësues të përkohshëm si dhe me veprimet e tij ka imponuar vullnetin e tij që përkundër se nuk ekzistojnë kushtet ligjore lëndën ta orientojë në drejtim të përfaqësuesit të përkohshëm, nuk është provuar me asnjë provë nga ana e parashtrueses. Gjatë shqyrtimit të procesverbalit gjyqësor shihet se nuk është konstatuar asnjë vërejtje nga palët si dhe përveç kësaj të gjitha palët janë nënshkruar pa vërejtje në procesverbal.

Në bazë të Ligjit për Procedurën Kontestimore neni 137 par. 2 është paraparë se *“Palët kanë të drejtë ta lexojnë ose të kërkojnë që t’u lexohet procesverbali, si dhe të paraqesin kundërshtimet e veta në përmbajtjen e procesverbalit”, si dhe “Korrigjimet apo shtesat lidhur me kundërshtimet e palëve apo të personave të tjerë në përmbajtjen e procesverbalit, apo me iniciativën e gjyqtarit, bëhen në fundin e procesverbalit. Me kërkesën e subjekteve të përmendura shkruhen në procesverbal edhe kundërshtimet e tyre të pa aprovuara nga gjyqtari.*

Veprimet e ndërmarra nga ana e gjyqtarit në seancë gjyqësore me qëllim të trajtimit të çështjes gjyqësore, janë në kompetencë ekskluzive të gjyqtarit të çështjes dhe të njëjtat veprime nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtarin, a po të pretendohet se gjyqtari i çështjes është treguar i paanshëm a po ka shkelur parimin e pavarësisë, kjo sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj a po të komentoj vendimet gjyqësore a po të komentoj veprimet procedurale të marra nga gjyqtari me qëllim të trajtimit të çështjes, kjo sepse kjo kompetencë i takon vetëm gjykatës së shkallës së dytë, që të vlerësoj nëse si rezultat i shkeljeve procedurale a po materiale të bëra nga gjykata e shkallës së parë është bërë konstatim i gabuar i gjendjes faktike a po është shkelur ligji në dëm të palës tjetër.

Andaj, Autoriteti Kompetent ka vlerësuar se aplikimi i gabuar dhe jo i drejtë i te drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtareve gjatë punës se tyre, mund të jete shkak për ushtrimin e ankesës nga ana e palës se pakënaqur ne Gjykatën e instancës me të lartë, e qe kjo çështje lidhet me aspektin profesional të gjyqtarit dhe e njëjta mund të shërbej si kriter në vlerësimin e performancës së gjyqtarit të caktuar, por jo të konsiderohet shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë së tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i

njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit".

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/01/25, me datë 12.02.2025

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë